



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS SPANJOLLE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
GJUHË E HUAJ C (1)

Ngarkesa: 6 kredite; 20 seminare; 40 leksione

Viti akademik/Semestri kur zhvillohet: Viti i I, semestri I

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Program profesional dyvjeçar në "Komunikim shumëgjuhësh në institucione dhe ndërmarrje."

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJET DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore:

- Të ndërveprojë, të jetë në gjendje të pyesë, të përgjigjet, të kërkojë ndihmë ose të japë një mendim për çështje themelore të jetesës së përditshme në përputhje me nivelin A1.
- Të ketë aftësi për të kuptuar, interpretuar dhe prodhuar tekste në spanjisht sipas nivelit A1.

Objektivat specifike lëndore:

- Të ketë aftësi për të fituar koncepte bazë të gramatikës, të ortografisë, dhe fjalorit.
- Të ketë aftësi për të komunikuar me dialogje të thjeshta.
- Të ketë aftësi njohuri mbi kulturën dhe traditat e Spanjës.
- Të ketë aftësi për të analizuar, krahasuar dhe nxitur arsyetimin logjik.
- Të ketë aftësi për të punuar në ekip dhe për të bashkëpunuar me persona të tjerë.
- Të ketë aftësi për të vlerësuar të tjerët dhe për t'u vetëvlerësuar.
- Të ketë aftësi për të konsultuar informacion në web.

Rezultatet e pritshme të të nxënit

1. Studenti do të jetë në gjendje të komunikojë në situata të thjeshta të jetës së përditshme në gjuhën spanjolle, duke përdorur dialogje, pyetje, përgjigje, kërkesa dhe shprehje të mendimeve në përputhje me nivelin A1.
2. Studenti do të jetë në gjendje të kuptojë, interpretojë dhe të prodhojë tekste të thjeshta në gjuhën spanjolle, duke përdorur në mënyrë të përshtatshme njohuritë bazë të gramatikës, ortografisë dhe fjalorit.
3. Studenti do të jetë në gjendje të identifikojë dhe të përshkruajë elemente bazë të kulturës dhe traditave të Spanjës, si dhe të analizojë dhe të krahasojë aspekte të ndryshme kulturore, duke zhvilluar arsyetimin logjik dhe kompetencën ndërkulturore.
4. Studenti do të jetë në gjendje të bashkëpunojë dhe të punojë në ekip, të vlerësojë punën e të tjerëve dhe të vetëvlerësojë përparimin e tij, duke përdorur gjithashtu burime të ndryshme, përfshirë informacionin online, për të mbështetur të nxënit e pavarur.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS GJERMANE



GJUHË E HUAJ C (1)

Ngarkesa: 6 kredite, 20 lex, 40 orë seminare

Viti akademik/Semestri kur zhvillohet: Viti I, sem I

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Program studimi profesional dyvjeçar në “Komunikim Shumëgjuhësh në Insitucione dhe Ndërmarrje”

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat lëndore:

1. Njohuritë:

- Përfthimi i njohurive gramatikore bazë në përputhje me nivelin gjuhësor të synuar
- Përfthimi i fjalorit komunikues bazë në përputhje me nivelin gjuhësor të synuar
- Njohja me rregullat bazë të shqiptimit dhe theksimit në gjuhën gjermane, për të shqiptuar saktë fjalët dhe fjalitë e thjeshta

2. Aftësitë:

Kjo lëndë zhvillon te studentët aftësitë:

- për të bërë pyetje të thjeshta, për t’u përgjigjur, për t’u prezantuar, për të folur për familjen dhe jetën e tyre të përditshme dhe për të komunikuar në situata shumë të thjeshta të përditshme;
- për të shkruar fjali dhe tekste të thjeshta, si p.sh. shënime, email-e ose kartolina;
- për të kuptuar udhëzime të thjeshta, biseda të shkurtra dhe informacione bazë në situata të përditshme, si blerjet ose prezantimi;
- për të lexuar dhe kuptuar tekste të shkurtra dhe të thjeshta.

3. Kompetencat:

Studentët janë në gjendje:

- të komunikojnë në situata shumë të thjeshta të përditshme në gjuhën gjermane;
- të përdorin strategji për të ndjekur përparimin e tyre në mësim, për të zgjeruar fjalorin bazë dhe për të konsoliduar gramatikën themelore;
- të reflektojnë mbi procesin e tyre të të mësuarit dhe të ndërmarrin hapat e parë për të përmirësuar njohuritë e tyre gjuhësore.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS FRËNGE

PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
GJUHE E HUAJ E DYTË C (1)

Ngarkesa: 6 kredite E.C.T.S, 20 orë leksione/40 orë seminare

Viti akademik: Viti I, Semestri I

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Programi i Studimit Profesional Dyvjeçar në “Komunikim shumëgjuhësh në institucione dhe ndërmarrje”

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivi i përgjithshëm: Lënda synon t’u mundësojë studentëve, të cilët kanë pak ose aspak njohuri paraprake në gjuhën frënge, të përvetësojnë njohuritë dhe aftësitë themelore gjuhësore të nivelit A1, në përputhje me Kuadrin Europian të Përbashkët të Referencave për Gjuhët. Nëpërmjet një qasjeje komunikative, ndërvepruese dhe të orientuar drejt studentit, lënda synon zhvillimin gradual të kompetencave gjuhësore, komunikuese dhe ndërkulturore, duke i aftësuar studentët të përdorin gjuhën frënge në situata të thjeshta të jetës së përditshme dhe të zhvillojnë strategji për të nxënë autonom të gjuhës.

Objektivat specifike :

Në përfundim të modulit, studenti synohet të jetë në gjendje:

1. Të përvetësojë fjalorin dhe strukturat themelore të gjuhës frënge të nevojshme për komunikimin në situata të thjeshta të jetës së përditshme.
2. Të kuptojë dhe të përdorë shprehje dhe fjali të thjeshta për prezantimin e vetes, dhënien e informacioneve personale dhe komunikimin me të tjerët.
3. Të zhvillojë aftësitë bazë të të dëgjuarit, të folurit, të lexuarit dhe të shkruarit në përputhje me kërkesat e nivelit A1.
4. Të përdorë strukturat themelore gramatikore të gjuhës frënge në funksion të komunikimit, duke i zbuluar dhe përvetësuar ato nëpërmjet shembujve dhe situatave konkrete.
5. Të komunikojë në mënyrë të thjeshtë në situata të zakonshme, si në klasë, në ambiente publike, gjatë blerjeve, në prezantime dhe në ndërveprime të përditshme.

Rezultatet e pritshme

Në përfundim të lëndës, studenti do të jetë në gjendje:

- Të identifikojë dhe të shpjegojë elementet themelore të sistemit gjuhësor të frëngjishtes në nivelin A1.
- Të njohë dhe të përdorë fjalorin bazë që lidhet me situata të zakonshme të jetës së përditshme.
- Të njohë elemente themelore të kulturës dhe jetës shoqërore franceze dhe frankofone.